



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.572-2/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Rrustem Thaçi dhe Faton Ademi, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me kërkesën për tërheqjen e apeleve Anr.572/2021, Anr.573/2021, Anr.574/2021, Anr.575/2021, Anr.576/2021 të parashtruar nga Arbër Rexhaj nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në seancën e Panelit, të mbajtur më datë 07.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet e palejuar kërkesa A.nr.572-4/2021 e datës 05.03.2021 për tërheqjen e apeleve, Anr. 572/2021, Anr. 573/2021, Anr. 574/2021, Anr. 575/2021, dhe Anr. 576/2021 të paraqitur nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Arbër Rexhaj nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), pasi që për këto apele është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr. 572/2021 të datës 05.03.2021.

A r s y e t i m

Me datë 05.03.2021, PZAP-i ka pranuar kërkesën A.nr.572-4/2021 të parashtruar nga Arbër Rexhaj nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën ka kërkuar tërheqjen e apeleve Anr. 572/2021, Anr. 573/2021, Anr. 574/2021, Anr. 575/2021, Anr. 576/2021. Parashtruesi i kërkesës kërkon me ngulm që të anulohen ankesat e tij pasi që siç thekson ai nuk dëshiron që procesi të vonohet.

Paneli, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së kërkesës gjeti se:

Kërkesa për tërheqje është e palejuar

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se kërkesa për tërheqje e parashtruar nga Arbër Rexhaj nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), është e palejuar pasi që për këto apele është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr. 572/2021 të datës 05.03.2021.

Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike rezulton se kjo çështje është **çështje e gjykuar “res iudicata”**.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr. 572/2021 të datës 05.03.2021, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në kërkesë.

Paneli, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e nenit 11.5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 572-2/2021 më datën 07.03.2021

Kryesues i Panelit
Adnan Konushevc



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.